VENDIM
Nr.2, datë 19.1.2007

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RISHIKIMIN E RREGULLORES SË PROCEDURAVE TË LICENCIMIT DHE RREGULLORES PËR PROCEDURAT E LICENCIMIT PËR NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E CENTRALEVE ELEKTRIKE ME KAPACITET TË PËRGJITHSHËM JO MË TË MADH SE 5 MW, DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KËTO CENTRALE

Në mbështetje të nenit 9 pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 24 të rregullores për procedurat e licencimit, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.37, datë 9.7.2004, dhe të nenit 15 të rregullores për procedurat e licencimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW, dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.44, datë 14.10.2004, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.1.2007,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për rishikimin e rregullores për procedurat e licencimit dhe rregullores për procedurat e licencimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW, dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale.
2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve, si dhe këshilltari i Bordit të Komisionerëve për përpunimin e ndryshimeve të këtyre rregulloreve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta